



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 19 i Regj.Themeltar
Nr. 19 i Vendimit**

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Sokol SADUSHI - Kryesues
Asim VOKSHI - Anëtar
Artur KALAJA - Anëtar

sot më datë 25.02.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që u përket palëve

KËRKUES: 1) Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit
2) Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile.

në çështjen me palë:

PADITËS: Besim Pasha, Hasan Pasha, Hazis Lala, Abdi Toçi, Sherif Koleci, Sali Koleci,

Avni Koleci, Dhimitër Koleci.

TË PADITUR: Enti Rregullator i Energjisë
Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr. 146, datë 10.09.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’u gjykuar për çështjet e mjedisit”, ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë”, Vendimi i Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016 “Rregullorja për rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, VKM nr. 661, datë 31.10.2018 “Për zgjerimin e sipërfaqes së PK Lurë dhe krijimin e PK Lurë-Mali i Dejës”

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Asim Vokshi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Besim Pasha, Hasan Pasha, Hazis Lala, Abdi Toçi, Sherif Koleci, Sali Koleci, Avni Koleci, Dhimitër Koleci, janë banor të Njesisë Administrative Drjan, Bashkia Mat, ku kanë edhe pronat e tyre.

2. Nga ana e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, me vendimin nr. 146, datë 10.09.2020 “*Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw*”, është licencuar pala e paditur për prodhimin e energjisë nga elektrike nga HEC-et “Sekë” dhe “Zais”.

3. Për sa më sipër, paditësit duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 49, datë 18.01.2021 ka vendosur:

“Pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë së paraqitur nga paditësit Besim Pasha etj. Shfuqizimin e pjeshëm të aktit administrativ vendimin nr. 146, datë 10.09.2020 të Entit Rregullator të Energjisë për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zais” me kapacitet 2295 kw. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objekti të kërimit si të pabazuar në ligj dhe prova.”

5. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 559, datë 10.11.2021 ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 49, datë 18.01.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”

6. Më datë 10.01.2022 Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- Ndaj vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit, kemi paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë për shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, për një proces të rregullt ligjor me pasojë mohimin e së drejtës për tu dëgjuar dhe mbrojtur, mungesën e tagrave të

përfaqësimit të avokatit, për paraqitjen e padisë, me zgjidhjen e çështjes në kundërshtim të plotë me ligjin material.

- Gjykata Administrative e Apelit në mënyrë të pabazuara në ligj dhe në prova ka shfuqizuar pjesërisht vendimin nr. 146, datë 10.09.2020, pasi nuk u provua fakti i pretenduar, i cili mund të cenonte vendimmarrjen e ERE.
- Bazuara edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për pranimin ose jo të kërkesë për pezullim, zbatohet për analogji edhe i kushteve ligjore që parashikohen nga nenin 29 të ligjit 49/2012.
- Ekzekutimi i vendimi do të cenonte rëndë procesin e vendimmarrjes së ERE, sepse kjo e fundit ka zbatuar me përpikëri detyrimet e ligjit nr. 43/2012 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nëse do të ekzekutohe ky vendim ERE do të shkelte ligjin nr. 43/2012. Nga ana tjetër ky pezullim nuk cenon rëndë interesin publik.

7. Më datë 07.01.2022 shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga Avokat Sajmir Dautaj, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- Ndaj vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit, kemi paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë për shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, për mungesën e njoftimit për datën dhe orën e gjykimit dhe të pretendimeve të palëve për kundërankim, për një proces të rregullt ligjor me pasojë mohimin e së drejtës për tu dëgjuar dhe mbrojtur, mungesën e tagrave të përfaqësimit të avokatit, për paraqitjen e padisë, me zgjidhjen e çështjes në kundërshtim të plotë me ligjin material.
- Gjykata Administrative e Apelit në mënyrë të pabazuara në ligj dhe në prova ka shfuqizuar pjesërisht vendimin nr. 146, datë 10.09.2020, pasi paditësit jo vetëm që nuk legjitimohen për kërkimin, porse nuk u provua fakti i pretenduar, i cili mund të cenonte vendimmarrjen e ERE.
- Bazuara edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për pranimin ose jo të kërkesë për pezullim, zbatohet për analogji edhe i kushteve ligjore që parashikohen nga nenin 29 të ligjit 49/2012.
- Ekzekutimi i vendimi do të cenonte rëndë do të sillte një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për shoqërinë koncesionare, e cila ka përfunduar ndërtimin e HEC-ve dhe është në fazën e operimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike prej muajit janar 2021. Aktiviteti i shoqërisë bazohet në kontratën e koncesionit për një afat 35 vjeçar dhe ekzekutimi i këtij vendimi do të sillte pasojë të rënda dhe të pariparueshme, pasi do ta kishte të pamundur të siguronte kthimin e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit dhe kthimin e investimit të realizuar, si dhe shlyerjen e kredisë bankare të marrë për këtë qëllim.
- Nga ana tjetër ky pezullim nuk cenon rëndë interesin publik, pasi së pari kët hidrocentrale janë vepra publike dhe në fund të afatit do ti transferohen autoritetit kontraktor dhe së dyti për shka të krizës energjetike, do të prodhohet energji me çmim më të lirë se ajo që blihet nga KESH dhe OSHEE 5-6 fish më të larta.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve

mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Në pikën 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohen kushtet dhe motivet për të cilat, Gjykata e Lartë, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor: “1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur: a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit. [...]”. Në analizë të kësaj dispozite, Kolegji vlerëson se objekt i kërkesës për pezullim janë vendimet gjyqësore të formës së prerë, ndaj të cilave është ushtruar rekurs nga palët ndërgjyqëse në Gjykatën e Lartë. Forma e prerë e një vendimi gjyqësor është atributi që i jep ligji procedural (neni 451 i KPrC) një vendimi gjykate, që e bën atë të ekzekutueshëm, pasi të jenë plotësuar kushtet e parapara me ligj. Nga ana tjetër Kolegji vlerëson se masa e përkohshme e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas nenit 479 të K.Pr.C ka karakter përjashtimor dhe të jashtëzakonshëm. Në të kundërt do të zhvleftësohej fuqia juridike e vendimit gjyqësor të formës së prerë, detyrueshmëria për zbatimin e tij nga palët ndërgjyqëse dhe mosezkektimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga përjashtim do të shndërrohej në rregull. Kjo do të vinte ndesh me të drejtën kushtetuese dhe konventore të kujtdo për të patur një proces të rregullt ligjor, e drejtë që përfshin jo vetëm fazën njohëse të së drejtës por edhe fazën ekzekutive. Kjo do të thotë se pala që e kërkon pezullimin ka barrën e paraqitjes së fakteve dhe argumenteve konkretë se cili është dëmi i rëndë që asaj mund t’i vijë nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe pse apo në çfarë mënyre ky dëm është me natyrë të parikthyeshme. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se koncepti “*pasoja të rënda*” në kuptim të nenit 479 të K.Pr.C nënkupton pasojat e drejtpërdrejta me karakter material që mund të sjellë ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë.

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Duke ju kthyer rastit në shqyrtim, paraprakisht Kolegji, thekson se dhe në funksion të zgjidhjes së saj, duke qenë dy kërkesa të depozituara në Gjykatën e Lartë me të njëjtin objekt, nga palë të të njëjtit proces, vendosi bashkimin e të dy kërkesave në një shqyrtim të vetëm, për sa kohë jemi përpara rastit ku objekti i të dy kërkesave është pezullimi i të njëjtit vendim të dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit.

15. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga avokat Sajmir Dautaj, është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

16. Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga avokat Sajmir Dautaj, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga Avokat Sajmir Dautaj, të cilët nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga avokat Sajmir Dautaj kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vlerëson se, kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë,

bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat do të vlerësohen në kohën kur të shqyrtohen në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

18. Për sa i përket argumentit që përfshihet në rastin e shkronjës “a”, të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji thekson se palët kërkuese kanë parashtruar dhe argumentuar lidhur me rrethanën konkrete që shërben për të vlerësuar se jemi përpara rastit, kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k.

19. Kolegji çmon të nevojshme të evidentojë se, duke mbajtur parasysh faktin se hidrocentrali për të cilin kërkohet licencimi nga ana e kërkesit, është i ndërtuar me leje ndërtimi dhe është në fazën e futjes në punë për prodhim energjie. Në këto kushte, vlerësohet se ka dyshim të arsyeshm për të menduar se kërkesit i shkaktohet një dëm i menjëhershëm nga vendimet e gjykatave më të ulta, i cili rrezikon të jetë i riparueshëm, ose i riparueshëm me kosto të mëdha për interesin publik. Vetë rrethanat e parashtruara në faktet e pranuar prej gjykatave më të ulta, nxjerrin në pah nevojën e pezullimit të ekzekutimit, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga Gjykata e Lartë. Ndaj, deri në shqyrtimin në themel të kësaj çështje dhe analizimit të argumenteve të vendimmarrjes së gjykatave më të ulta, lind nevoja të pezullohet zbatimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë.

20. Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese, Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga avokat Sajmir Dautaj për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar) dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Pranimin e kërkesave të paraqitura nga Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k, përfaqësuar nga avokat Sajmir Dautaj.

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 559 (86-2021-671), datë 10.11.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më datë 25.02.2022

ANËTAR

Artur KALAJA

ANËTAR

Asim VOKSHI

KRYESUES

Sokol SADUSHI